

HISTORIA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE ISLAME TË ZONËS SË SHKODRËS: MEJTEPET

Depërtimi në shkallë të gjerë i fesë islame në radhët e popullsisë shqiptare gjeti shprehje pikë së pari në qytete. Me vendosjen e osmanëve në qytetet shqiptare ato filluan të funksionojnë si qendra administrative, ekonomike dhe kulturore të sistemit të ri politik. Në përshtatje me rolin e tyre ekonomik e shoqëror, në qytet u përqendrua jo vetëm shumica e personelit administrativ dhe ushtarak, por edhe misionarët, ulematë, dijetarët e predikuesit islamë, në fillim të ardhur nga jashtë dhe më vonë vendas, së bashku me institucionet e kultit, që u ndërtuan dhe u shumuan.

Në konvertimin në Islam nuk ka pasur dhunë, por çdo gjë me dëshirë. Edhe nëse ka ekzistuar ndonjë rast nga persona të veçantë për të ushtruar ndikimin e tyre, ata janë penguar nga ligjet e shariatit. P.sh., dy prej sulltanëve osmanë, Selimi I (1512-1520) dhe Murati IV (1623-1640), që projektuan islamizimin me forcë të gjithë popullsisë së krishterë të perandorisë, u detyruan të hiqnin dorë që në fillim prej këtij projekti, për shkak të kundërshtimit të vendosur të drejtuesve të lartë myslimanë-ulemave, dijetarëve dhe të shehut islam të kohës, që nuk i dhanë lejen përkatëse, fetvan, për një veprim të tillë, sepse ishte në kundërshtim me parimet e fesë islame. Sami Frashëri ka evidentuar se:

“Përhapja e fesë islame ka edhe një të vërtetë tjetër të rëndësishme, të cilën e kanë fshirë historianët. Është ky realitet i përhapjes së fesë vetvetiu, pa shpatë dhe pa ushtarë. Ky realitet i fundit, nëse s’është më i madh se i pari, atëherë sigurisht që është i barabartë me të parin”.¹

Këtë frymë përcjellin edhe ajetet kuranore:

“Nuk ka dhunë në fe” (El-Bekare, 256); “Thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira” (Kurani, surja

1 S. Frashëri, *Përhapja e heronjve në përhapjen e Islamit*, f. 2. 26.

En-Nahl, 125); "E vërteta është nga Zoti juaj e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë!" (El Kehl, 29); "Ju keni fenë tuaj dhe unë kam timen" (El Kafirun, 6).

Mejtepet, ruzhdijet dhe medresetë

Përhapja e fesë islame dhe shtimi i popullsisë myslimane diktoi ngritjen e institucioneve fetare dhe atyre arsimore. Me rritjen e lagjeve dhe të popullsisë myslimane, pothuajse çdo lagje ka pasur xhaminë e vet. U bë zakon dhe traditë, që në çdo qendër lagjeje të qytetit dhe të fshatit, të ndërtoheshin xhami, teqe, mejtepe, të cilat u shoqëruan edhe me ndërtimin e komplekseve arsimore e kulturore, në shërbim të tyre. U ndërtuan çezma, puse, hamame nga bamirës me zemër të madhe e bujare. Në shërbim të këtyre objekteve u ndërtuan edhe dyqane për mirëmbajtjen e tyre, u shtuan tokat e vakëfeve, ullishtat, bagëtitë etj. Zhvillimi i besimit islam në Shqipëri, kryesisht në Shkodër, u shoqërua edhe me ndërtimin e institucioneve arsimore e kulturore fetare, si mejtepe, ruzhdije dhe medrese. Fillimisht u ndërtuan mejtepet, që ishin në godina më vete, pranë xhamive dhe në vende të tjera.

Informacionet e mbledhjes së parë të Drejtorisë së Vakëfit të Shqipërisë, të datës 23 tetor 1917, në Shkodër², tregojnë se është bërë një punë e madhe për të dokumentuar saktë objektet e kultit, së bashku me vlerat e tyre, nga drejtori i vakëfit, z. Izet efendi Pertev, i cili, ndër të tjera, thotë:

"Veç kësaj, ka 451 ndërtesa feje, 250 xhami, 73 ndërtesa shkollë, 128 të tjera ndërtesa feje".

Administrata osmane, në bazë të politikës së saj, më shumë ishte e interesuar për hapjen e shkollave të nivelit të ulët dhe këto në gjuhët arabe e turke. Në qytet u hapën shkollat e para me katër klasë fillore (iptadije) dhe ato me tri klasë ruzhdije e qytetëse, që fillonin pas nivelit fillor. Kështu, shkolla e parë ruzhdije e Pazarit të Vjetër të Shkodrës, pas pesë viteve ekzistencë, u transferua në qytet, më pranë banesave të nxënësve, madje në qendër të tij, në Fushë Çelë.

Siç e cekëm edhe më lart, ngritja e Medresesë së Qafës dhe e Pazarit të Vjetër me kontributin e Mehmet pashë Plakut dhe të djalit të tij, Karamahmud Pashës, të ndërfutura në kompleksin arsimor të Pazarit të Vjetër, në harkun kohor 1760-'70, luajtën një rol të rëndësishëm në

2 Botuar në gazetën "Posta e Shqipërisë", e datës 10 nëntor 1917.

zhvillimin e arsimit në Shkodër. Në Pazar të Vjetër mendohet të ketë qenë edhe një tjetër medrese, por dokumentacioni për të mungon. Deri në vitin 1902, nuk pati ndonjë shkollë të mesme të avancuar, me përjashtim të medreseve. Në këtë vit u hap shkolla “Ruzhdije Asqeri”.

Rrjeti i shkollave shënon një rritje që ecte paralelisht me zgjimin e ndërgjegjes kombëtare. Ka dokumente që vërtetojnë se në vitin 1894-‘95 ekzistonin 101 shkolla të tilla në qytet e në fshat, 75 të sistemit të vjetër e 26 shkolla të sistemit të ri. Hapet shkolla “Ruzhdije”, e cila kishte 103 nxënës me 4 mësues. Po ashtu, ishin shkollat iptadije qytetëse dhe gjimnazi. Mësimet jepeshin në turqisht e arabisht dhe shkallë-shkallë, hynë edhe lëndët e kulturës së përgjithshme dhe gjuha shqipe, e cila, pas Kongresit të Manastirit, më 1908-n, nisi të shkruhej me germa latine.³

Shkollat qytetëse e fillore kishin gjithsej 9 mësues dhe 640 nxënës, funksiononin dy medrese, një bibliotekë dhe 17 shkolla të besimit islam.⁴

Në Shkodër, në dobi të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe edukativ, qe ngritur e funksiononte edhe një këshill shkollor. Ky organizim mund të ketë qenë edhe në qarqe apo vilajete të tjera, por për mungesë dokumentacioni, nuk mund ta konfirmojmë. Këshilli arsimor përbëhej nga drejtori i arsimit me anëtarë: Jusuf efendi Ismail Begu, myderriz Omar Efendiu dhe sekretar Fejzi Efendiu. Ky këshill vendoste për probleme organizative, administrative dhe ekonomike. Kryetar i këshillit, në vitin 1913, ka qenë Xhemal efendi Naipi, më vonë Hysen efendi Vuthi, Hafëz Ibrahim Repishti, Mustafa Kruja etj.

Në vitin 1913 deri në vitin 1925, në këtë këshill kanë bërë pjesë mësuesit e nderuar: Haxhi Hafëz Abaz Golemi, Pater Gjergj Fishta, Gaspër Mikeli, Sheuqet Muka, Gaspër Beltoja, Rustem Lopçi, etj.⁵

Mejtepet

Për të kuptuar në vijimësi arsimimin e fëmijëve të kësaj kohe, nëpërmjet klerikëve, kuvendeve etj., duhet të theksojmë se arsimit paramedresor ishte i nivelit të mejtepeve, që nënkupton xhami, mesxhit – xhami e vogël dhe pa minare dhe mejtep. Në xhami apo në mesxhite, të rriturit, së bashku me hoxhën, ndikojnë mbi fëmijët, në mënyrë që ata të përvetësojnë sa më mirë vlerat e caktuara të sjelljes, të edukatës dhe të moskryerjes së veprimeve të

3 Muzeu Historik Shkodër, pako 7, dosja 2, viti 1917-‘18, Vjenë 28-61, nr. 119, dt. 17.1.1918, f. 44, 45, 46. Të dhënat u nxorën nga raporti i arsimit në Shkodër.

4 Njazi Kazazi, të dhëna të nxjerra nga Sehatnamja e vitit 1313 (1897, S. Bala).

5 *Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës (1662 – 1945)*, v. 1, f. 29.

papëlqyera e nënëmësimet e tyre, të mësojnë se si duhet vepruar në jetë. Në mejtepe fëmijët merrnin jo vetëm dije teorike dhe praktike elementare mbi fenë islame dhe se si duhet të sillej fëmija në familje e në shoqëri, por ata merrnin edhe një nivel arsimor që nuk duhet anashkaluar.

Fillimisht, u ngritën shkolla-mejtepe të nivelit të arsimit fillor. Fjala “mejtepe” rrjedh nga fjala arabe “Kebute-Kutaletum” – të shkruash, që në fakt nënkupton vendin ku merret dija për shkrimin. Kësaj fjale, orientalisti i shquar Tahir N. Dizdari i jep këtë interpretim: “*Ndërtesa dhe instituti ku jepeshin mësimet në kohë të sundimit osman, mësonjëtoje, shkollë*”.⁶ Këto mejtepe nuk kanë pasur të njëjtën fizionomi, qoftë nga struktura, ashtu edhe nga programet.

Në Shkodër, mund të themi se mejtepet u hapën në dy kohë të ndryshme. Në fazën e parë kemi hapjen e mejtepeve përballë kalasë “Rozafa” të Shkodrës dhe kryesisht në Pazar të Vjetër, në ndërtesa më vete, ku përgjithësisht jepte mësim një hoxhë që drejtonte të gjithë veprimtarinë e tij dhe vetë mejtepi, siç edhe e kemi theksuar, merrte emrin e hoxhës që jepte mësim. Në fazën e dytë, mejtepet u atashuan (u ndërtuan) përballë xhamive të lagjeve të qytetit të Shkodrës dhe atyre të fshatrave. Këtu jepte mësim imami i xhamisë, por kishte edhe mejtepe më vete, që drejtoheshin nga një mësues i besimit, një hoxhë.

Datë të saktë se kur u hapën mejtepet në Pazar të Vjetër, nuk kemi, por mendohet që ato janë hapur para ruzhdijeve dhe medreseve. Studimet e mëvonshme, veçanërisht ato të regjistrimit të vitit 1910-’11 dhe të Tahir Emlaq, përmendin, ndër të parat, mejtepin e Molla Ferhatit, në vitin 1830. Mejtepet janë hapur shumë më herët, edhe para vitit 1662, siç e ka përmendur qartë Evlija Çelebiu.

Mejtepet në Pazar të Vjetër qëndruan të hapura deri në vitin 1910, kohë në të cilën roli i këtij pazari erdhi duke rënë, pasi tregtia u zgjerua në qytet dhe tani fëmijët shkodranë vijuan të merrnin mësimet në mejtepet e lagjeve të tyre.

Mejtepet kanë qenë niveli fillestar i shkollimit, pra ai fillor. Ato ishin të mirorganizuar, të konsoliduara, me një qendër administrative dhe kontrolli, që nga Stambolli e shkallë-shkallë zbrisnin deri në rang qyteti e myftinie. Në mejtepe jepte mësim një hoxhë i arsimuar për kohën, i cili paguhej nga prindërit e fëmijëve. Në raste festash e ceremonish të mejtepit, atyre u jepeshin dhurata, por ka pasur raste që hoxhallarët-mësues të jenë

6 Tahir N. Dizdari, *Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe*, botim i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam dhe i Organizatës Islame për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, Tiranë, 2005, f. 636.

paguar nga shteti me 100 franga ari në muaj.

Nxënësit fillonin këtu mësimet në moshën 7 vjeç dhe vijonin deri në moshën 11 vjeç. Programi niste me mësimin e alfabetit arabisht, që do të shërbente për leximin e mësimin e Kuranit, duke e shkruar atë në një fletore të veçantë. Programi vijonte me Elefbenë arabisht dhe pjesë fillestare të besimit islam, pastaj kalohej në Jasinë, e cila duhej mësuar përmendësh. Mësoheshin katër veprimet themelore të aritmetikës, aq sa nxënësi e më vonë i rrituri ishte i aftë të llogariste problemet e thjeshta praktike. Në klasat më të larta dhe më vonë mësoheshin veprime të tjera matematikore, kaligrafi, turqisht etj. Mësimet zhvilloheshin rregullisht, nxënësit qëndronin të ulur në gjunjë para hoxhës. Nxënësit, sipas klasave, ishin të ndarë nëpër rreshta. Kështu, rreshti i parë i korrespondonte klasës së parë, e kështu me radhë. Secila klasë kishte një ose dy stola të gjatë, në vend të bankës, për të mbështetur librat dhe për të shkruar. Fëmijët rrinin të grumbulluar në një dhomë, ndryshe, për t'u kuptuar, bënë mësim në klasë kolektive. Gjatë mëimit, kur nxënësi nuk e kishte vëmendjen ose kur hoxha donte t'u komunikonte diçka, të gjithë duhet të ndërprisnin leximin apo shkrimin dhe ai i binte me thupër dyshemesë. Fëmijët mbaheshin në mejtepe prej mëngjesit e deri në darkë. Drekën secili e merrte me vete dhe e hante aty.

Në vitet e fundit u futën metoda më të avancuara mësimdhënieje, që u përvetësuan nga hoxhallarët-mësues. Kjo krijoi një vijimësi të suksesshme, pasi djemtë që kryenin mejtepin, kishin të drejtë të vijonin shkollimin e mëtejshëm, në medrese apo në ruzhdijet e Shkodrës e më tej.

MEJTEPET E QYTETIT TË SHKODRËS

1. Mejtepi i Molla Ferhatit

Mejtepi që mban emrin e tij mendohet të jetë hapur rreth vitit 1830. Ai ka qenë pas dyqaneve, buzë rrugës që shkon në Teqenë e Bagëtime, në rrugën e lagjes “Qafë”. Në këtë mejtepe e kaloi fëmijërinë e tij Daut Boriçi.⁷

2. Mejtepi i Molla Halil Boriçit

Halil Boriçi ishte vëllai i Daut Boriçit. Mejtepi i tij ka qenë pranë Tyrbes së Zojës së Pazarit, Xhamisë së Teqesë, Teqesë së Bagëtime, në lagjen “Qafë”.

7 Në ditarin e tij, ai shënon: “Prej Ahmet efendi Hadrit kam nisë të mësoj librin “Dyrel”. Po në vitin 1263 H. (1845-S.B.), në xhamazul-evvel.

3. Mejtepi i Molla Mustafës

Mejtepi që mban emrin e tij mund të jetë edhe i fundit që dha mësim në këtë mejtep. Ndërtesa ka qenë në Rrugën e Kovaçëve, pas dyqaneve, duke shkuar në fushën e Teqesë së Bagëtime, pranë kodrës, në rrugën pas dyqaneve të Pazarit të Vjetër.

4. Mejtepi i Molla Kamerit

Mejtepi ka qenë i ndërtuar disa hapa pranë mullirit të Danejve, në rrugën që të çon në lagjen “Qafë”. Ai që ndërtuar për bamirësi nga i vëllai i tij, Molla Mustafa, i cili mund të ketë dhënë mësim më përpara, se, siç kemi thënë, mejtepet merrnin emrin e atij hoxhe që jepte mësim në atë periudhë dhe, pas tij, merrte emrin e hoxhës që e zëvendësonte.

5. Mejtepi i Molla Abdylit

Ky mejtep ka qenë në hyrje të Teqesë së Bagëtime. E ndërtoi për bamirësi Halil Hamza Efendia. Më vonë, me hapjen dhe kalimin e rrugës në atë vend, ndërtesa e mejtepit u shpronësua nga administrata turke. Për të njëjtin qëllim, ishte prishur edhe ruzhdija e Pazarit të Vjetër, që daton me datat e përafërta 1857-‘65, çka na bind për hershmërinë e këtyre mejtepeve.

6. Mejtepi i Molla Abdylit të Vogël

Edhe ky mejtep ka qenë pranë Xhamisë së Teqesë, në rrugën e lagjes “Qafë”, pra në atë pellg. Gjatë hulumtimeve, del se edhe ky mejtep është hapur shumë herët dhe se mësuesi, Molla Abdyli, është i fisit Shpori, stërnipat e të cilit sot jetojnë në lagjen “Garuc” të Shkodrës. Kjo familje e ka trashëguar imamllëkun (haxhillëkun) deri vonë dhe i fundit hoxhë i këtij fisi ka qenë Hafëz Isa Shpori, imam në xhaminë e fshatit Drisht të Postribës. Mejtepi ka ekzistuar deri vonë dhe, pas çlirimit, ai u kthye në teqe për muridët e tarikatit “Tixhani”, nën udhëheqjen e sheh Qazim Çelebisë (Hoxha).

7. Mejtepi i Molla Hysen Shazit

Mejtepi ka qenë në mes të Tyrbes së Simiçive dhe rrugës pas dyqaneve.⁸

8. Mejtepi i Molla Sylos

Edhe ky mejtep ka qenë në rrethin e sektorit të Teqesë së Bagëtimeve.

9. Mejtepi i Molla Jakupit

Ky mejtep ka qenë i ngritur pranë Xhamisë së Kullukhanes. Ishte një ndërtesë njëkatëshe me sipërfaqe 96 m². Pas vdekjes së tij, këtu ka dhënë mësim Hafëz Hasan Tahmizi.

10. Mejtepi i Hafëz Ibrahim Dibrës te Xhamia Plakë

Ky mejtep është pasues i mejtepit të Molla Medos dhe një ndër 19 mejtepet e hapura në Shkodër, që filluan mësimet në gjuhën shqipe, në vitin 1919, sipas një urdhri të Ministrisë së Arsimit, Tiranë. Mësues u emërua Hafëz Ibrahim Dibra. Duke qenë ky Hafëz, hoxhë i aftë dhe i përgatitur, e përkrahën shumë shpejt hapjen e mejtepit dhe pati një pjesëmarrje të lakmueshme. Shembulli i mësimdhënies së tij dhe i asimilimit të programeve nga ana e nxënësve në këtë mejtep, u përgjithësuan si ndër më të mirat e kohës, ndaj dhe mejtepi mori emrin e Hafëz Ibrahim Dibrës. Ai renditej ndër ata hoxhallarë, që mësimet i bënte të pëlqyeshme dhe të kuptueshme për nxënësit. Ndaj ky mejtep në kohën e tij vlerësohej shumë dhe ishte shembull për të gjithë hoxhallarët e tjerë. Hafëz Ibrahim shquhej për ëmbëlsinë e rrjedhshmërinë në bisedë, njeri zemërbardhë, i thjeshtë dhe mjaft i komunikueshëm me njerëzit, por dhe kërkues ndaj vetes dhe të tjerëve. U nda nga jeta më 3.01.1976.⁹

11. Mejtepi i Molla Haxhi Tahirit të Molla Hysenit

12. Mejtepi i Molla Mahmudit të Hafëz Ismailit

Edhe ky mejtep ka qenë në periferi të Teqesë së Bagëtimeve dhe Xhamisë së Teqesë. E veçanta e këtij mejtepi është se aty kanë dhënë mësim edhe

1945) V. 1, f. 31.

9 H. Bushati, vep. e cit., vëll. II, f. 32. "Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës" (1662 – 1945) v. 1. Për jetëshkrimin e Hafëz Ibrahimit autori ka shfrytëzuar këto burime e dokumente: S. Bala, vep. e cit., viti 2005, f. 304, 305, 306; H. Bushati, vep. e cit., vëll. II, f. 32; AQSHSH, Fondi 488 i KMSH-së, viti 1917, dosja 8; viti 1941, dosja 6, fl. 40, 41; Viti 1950, dosja 4; Dekreti 114, dt. 1.04.1950, 1952, dosja 10; dekreti nr.7, dt. 12.01.1953, dosja 3, fl. 131; Dekreti 125, dt. 25.04.1951; Viti 1962, dosja 11, f. 81.

vëllezërit e tij, Molla Agoja dhe Molla Fakoja dhe po aty, mori mësimet fetare edhe rilindësi i shquar, Daut Boriçi.

13. Mejtepi i Molla Mahmud Nallbanit

Mejtepi ka qenë pas Xhamisë së Hynqerit të Selvisë, sa kalon Rrugën e Vëve, në rrugën e lagjes “Qafë”.

14. Mejtepi i lagjes “Qafë”

Për këtë mejtep ka shumë pak të dhëna. Në pasurinë e vakëfit të Myftinisë së Shkodrës figuron me emërtimin “truall shkollë”, çka na tregon një kohë të hershme të ndërtimit të saj. Në këtë mejtep ka marrë mësimet Hafëz Esat Myftia, ish-kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar, dhe ka dhënë mësim Hafëz Rexhep Bërdica.¹⁰

15. Mejtepi i Hafëz Harapit

Mejtepi ka zhvilluar mësimet në shtëpinë e Jakup Dervisheviqit, më pas në pronësi të familjes Perdej, përballë furrës së Bejlikut, në rrugën “Naim Gjylbegu”. Këtu dha mësim një hoxhë zezak, prandaj dhe mori emrin “Mejtepi i Hafëz Harapit”. Falë shkollimit të tij dhe jashtë sferës fetare, ai nxënësve, veç lëndëve fetare dhe të fesë islame, u mësonte edhe njohuri nga shkencat, si nga matematika, historia, gjeografia etj. Puna e Hafëz Harapit vlerësohej shumë nga nxënësit dhe komuniteti i prindërve për lidhjet organike që bënte mes të teologjisë islame dhe jetës së përditshme. Mësimet i zhvillonte në gjuhën turke, kështu që fëmijët, përveç arabishtes, mësuuan prej tij edhe gjuhën që ai fliste. Në mejtepe mësohej arabishtja, por, sipas të dhënave të shtypit të kohës, në vitin 1913, ata përkrahën vendimet e qeverisë së Ismail Qemalit dhe në programe futën edhe gjuhën shqipe. Në një artikull, shkruhet: “*Merret vesh se në Shkodër do të çelen 19 mejtepe, të gjitha në gjuhën shqipe*”.¹¹

Mbi këtë bazë, Ministria e Arsimit e kohës hartoi edhe programet përkatëse, pasi ishte e bindur se hoxhallarët-mësues e zotëronin gjuhën shqipe dhe e realizonin mësimdhënien e saj më së miri. Me këtë rast, nga kjo ministri, ata morën edhe emërimet përkatëse, duke dhënë mësim në

10 AQSHSH, F. 488 i KMSH-së, viti 1926, dosja 20, në nr. e regjistrimit 24, fleta 112. *Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës (1662 – 1945)* v. 1, f. 37.

11 Gazeta “Shqipnia e re”, viti I, nr.24, dt. 25.09.1913, Smajl Bala, f. 38.

shkollat shtetërore laike, siç qenë të emëruar edhe mësuesit e kulturës së përgjithshme, ndaj në këtë libër do të përfshihen pikërisht këta mësues.

Hafëz Harapi kërkonte rregull e disiplinë dhe, pas një inspektimi të Seksionit të Arsimit në Shkodër, udhëzoheshin mejtepet e tjera që të ndiqnin shembullin dhe metodën e Hafëz Harapit. Hafëzi mbante petkun fetar, i cili i kishte hije. I drejtë, i rregullt dhe me teologji të lartë islame të përfunduar në Stamboll, ai la gjurmë të pashlyeshme në memorien e bashkëkohësve e më tej, deri në ditët tona.¹²

16. Mejtepi i lagjes “Bahçallëk”

Ndërtimi i tij është i hershëm, ashtu si edhe xhamia. Lagja “Bahçallëk” është ndër lagjet më të vjetra të qytetit të Shkodrës. Mejtepin e përmend edhe Evlija Çelebiu në *Sehatnamen* e tij, në vitin 1662. Përshkruhet si një ndërtesë 6m gjatësi, me 4 m lartësi, me 3 m gjerësi, me dritare të vogla nga oborri, me 4-5 këmbë shkallë, e mbuluar me tjegulla vendi dhe e vendosur përballë dhe në oborrin e xhamisë. Oborri ka qenë në formën e një katërkëndëshi të rregullt, me një sipërfaqe 500 m². Gjatë viteve, i janë bërë riparime. Orenditë janë të stilit të vjetër dhe në vite kanë ardhur duke u shtuar.

Mësimet fetare janë zhvilluar njëjloj si në të gjitha mejtepet e tjera edhe gjatë viteve. Sipas hulumtimeve të mia, këtu kanë dhënë mësim: Hafëz Ahmet Pipi (Bushati), Sheh Muhameti, Molla Ibrahim Bilani, Hafëz Adem Shehi, Hafëz Rexhep Bërdica, Hafëz Veli Kruja, Hafëz Jonuz Doda. Në vitin 1921, mejtepi u kthye për tri vjet në shkollë fillore për fëmijët e lagjes “Bahçallëk” dhe përsëri u kthye në mejtep. Mbas çlirimit, përsëri u kthye në shkollë e më pas në kopsht fëmijësh. Në vitin 1979 u dëmtua rëndë nga tërmeti i atij viti dhe u shkatërrua.¹³

17. Mejtepi i lagjes “Ajasëm”

Është një ndër mejtepet më të hershme në Shkodër, madje para vitit 1691, i ndërtuar së bashku me xhaminë. Ai ka qenë ndërtuar me kontributin financiar të banorëve të lagjes, në oborrin e xhamisë. Qe një ndërtesë njëkatëshe me dy dhoma, me dritare të vogla, me dy-tri këmbë

12 Bushati, vep. e cit., vëll. II, f. 32; S. Bala, vep. e cit., f. 58, 59, Smajl Bala, f. 40.

13 Për përshkrimin e këtij mejtepi, autori është mbështetur në këto burime e dokumente: S. Bala, vep. e cit., 2005, f. 116; AQSHSH, fondi 488 i KMSH-së, dosja 23 pa vit, nr. rendor 1861, nr. i procesverbalit 447, viti 1926, dosja 20, nr. 178, fleta 127. *Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës (1662 – 1945)*, v. 1, f. 43.

shkallë në hyrje, meqë ishte e ndërtuar në një rrafsh të pjerrët rrëzë kodrës, i rrethuar me mur guri. Në vitin 1691, mësuesve të tij iu dha rrogë 5 akçe në ditë, si shpërblim nga Dervish Efendia, bazuar në vakëfnamen e Hasan Bim Muhamedit, kadi i Shkodrës. Në vakëfname shkruhet:

“Mësuesit që mëson në mejtepin e ndërtuar pranë zavijes (tyrbe e vogël), prej të ndjerit sheh Dervish Efendisë, në lagjen “Xhamia e Madhe” (Ajasëm), nga 5 akçe në ditë (pare) nga interesi i shumës së përmendur, viti 1691”.

Mejtepi që i njohur në Shkodër për përvetësim të dijeve fetare islame dhe disiplinë të rreptë në kohën që ishte mësues Hafëz Jakup Çoba dhe, me kthimin në shkollë filllore për vajza, përsëri ai dha mësim. Në vitin shkollor 1923-‘24, mejtepi u kthye në shkollë për vajza. Gjatë kësaj kohe, u krijua korrespondenca e inspektorit të arsimit, Ismail Anamali, dhe në një ndër kërkesat e tij, ai shkruan dhe sqaron:

“Zyra e vakëfit këtu don me folë për ndërtesën e shkollës femërore në Ajasëm, që gjendet afër xhamisë dhe sot përdoret prej kësaj zyre dhe sot kjo ndërtesë nuk i përket vakëfit, mbasi nuk është ngritë (ndërtuar) me të hollat e tij, por me ndihmën e popullit të asaj lagjeje dhe apostafat për të mësuar fëmijët e tyre”. Shkolla aty nuk qëndroi shumë gjatë, për arsye se ishte e papërshtatshme dhe në degradim e sipër dhe, si e tillë, u prish. Në vite, në këtë mejtep dhanë mësim: Haxhi Sheh Muhameti, Molla Kamberi, Shaban efendi Domni, Hafëz Rexhep Bërdica, Hafëz Jakup Çoba, Hafëz Mustaf Ulqinaku.¹⁴

18. Mejtepi i lagjes “Tepe”

Thuhej se ky mejtep i kalon 250 vjet jetë të ndërtimit e funksionimit të tij. Ka qenë një ndërtesë dykatëshe, me dy dhoma poshtë e lart, me 8 m gjatësi, 6 m lartësi e 3 m gjerësi. Në kohën që jepte mësim Molla Ahmet Ulqinaku, mejtepi fitoi nam në të gjithë Shkodrën për nivelin e lartë të përgatitjes së nxënësve, të një kërkesë e disipline të rreptë që ai kërkonte. Ishte shumë i përgatitur. Krahas studimeve fetare që kishte kryer, kishte fituar një përvojë të mirë nga babai i tij, Hafëz Hylja, i cili ka qenë myfti i Ulqinit. Pas çlirimit dhe hapjes së shkollave filllore, mejtepi u kthye në

14 Për përshkrimin e këtij mejtepi, autori është mbështetur në këto burime e dokumente: S.Bala, vep.e cit., 2005, f. 138; H.Bushati, vep.e cit., Vëll.II, f. 32; AQSHSH, fondi 448 i KMSH-së, dosja 23, pa vit, nr. rendor 1860, nr.i procesverbalit 446; Viti 1926, dosja 20, nr.223, fleta 132.

kopsht dhe më vonë u prish krejtësisht.

Në vite, në këtë mejtep dhanë mësim: Taip Efendia, Hafëz Ibrahim Dibra, Hafëz Taip Hafëzi, Holla Ahmet Ulqinaku, Haxhi Hafëz Abdyl Mexhidi, Hafëz Ymer Zaganjori, Hafëz Halil Puka, Hafëz Rexhep Molla, Hafëz Man Rragami, Hafëz Sulejman Dibra, Hafëz Mustaf Ceka, Hafëz Caf Abdyli, Hafëz Mustaf Ulqinaku, Hafëz Zelë Ulqinaku.¹⁵

19. Mejtepi i lagjes “Tophanë”

Ky mejtep është ndërtuar në një kohë me xhaminë, në vitin 1617, nga Mustafa Efendia. Ka qenë një ndërtesë njëkatëshe, me përmasë e dritare të vogla, afër xhamisë e përbri rrugës “Lek Dukagjini” dhe Rrugës së Tophanës. Mejtepi ka qëndruar deri vonë, afërsisht deri në vitin 1936, por nuk u shfrytëzua për mësim, për shkak të amortizimit të tepërt dhe u përdor nga xhamia. Me kërkesat e qytetarëve për të hapur shkollë për fëmijët e tyre, u kërkuar të jepeshin fonde e të riparohesh për shkollë. Në këtë mejtep kanë dhënë mësim: Hafëz Abdyl Spahia, në vitin 1832, Hafëz Halil Tophana i Parë, Hafëz Ymer Shami, Hafëz Lalo Tophana, Hafëz Halil Tophana, Hafëz Rexhep Zylyftari, Hafëz Jonuz Jahja, Hafëz Halil Trepçi, Hafëz Sulejmani, Hafëz Abdyl Gavici, Hafëz Rexhep Hajdari, Hysni Buliqi, Hafëz Halil Puka.¹⁶

20. Mejtepi i lagjes “Parrucë”

Edhe ky mejtep ka qenë ndërtesë më vete. Aty dhanë mësim shumë emra të njohur, por më shumë spikati, kur aty punoi Molla Faslia, i cili, me përgatitjen e lartë, përkushtimin dhe metodat e përparuara që aplikoi, bëri që nxënësit të kishin një përvetësim cilësor të lëndëve teorike fetare, por dhe atyre të përgjithshme. E veçantë ishte se këtu u emërua edhe një mësues laik. Si i tillë, ai u bë një ndër mejtepet më të zëshëm e të ndjekur në Shkodër. Studiuesi i njohur, Prod. Dr. Musa Kraja, shkruan:

*“Puna e mësuesve pranë institucioneve fetare myslimane
“mejtepe” vjen e shtrihet sa në një lagje në një tjetër dhe në*

15 Për përshkrimin e këtij mejtepi, autori është mbështetur në këto burime e dokumente: S.Bala, vep.e cit., 2005, f. 138; H.Bushati, vep.e cit., Vëll.II, f. 32; AQSHSH, fondi 448 i KMSH-së, dosja 23, pa vit, nr. rendor 1860, nr. i procesverbalit 446; Viti 1926, dosja 20, nr. 223, fleta 132.

16 Për përshkrimin e këtij mejtepi, autori është mbështetur në këto burime e dokumente: S.Bala, vep.e cit., 2005, f.251-252; AQSH, idem, dosja 23, pa vit, nr.rendor 1783, i procesverbalit 629, viti 1926; Dosja 20, nr.55, fleta 115.Smajl Bala, f.44.

disa prej tyre, ndonëse me dy mësues, grumbulloheshin qindra fëmijë. P.sh., në Shkodër ka qenë i njohur Molla Medja me të vëllanë, Molla Sala dhe Molla Faslia. Në shkollën e Molla Medos e Molla Faslisë u bënë edhe ndryshime, sepse atje u dërgua edhe nga një mësues laik që mësonte nxënësit më të zgjuar. Atyre u mësohej, përveç turqishtes, këndim, diktim, gramatikë, bukurshkrim e jepeshin edhe njohuri elementare nga lëndë të tjera si aritmetika, historia, historia e sulltanateve të Turqisë, gjeografia. Pra, mësuesi laik kryente një seleksionim masiv të fëmijëve. Ndër mësuesit e parë që zbatuan këto lëndë, ishte Riza Kisha. Në një shkollë me program më të zgjeruar, afërsisht si shkollë 8-vjeçare, ishte ajo me drejtor Abaz Golemin, një mësues-hoxhë i nderuar në qytet”.¹⁷

21. Mejtepi i lagjes “Perash”

Ky mejtep ka qenë pranë qendrës së kryqëzimit të Perashit, afër xhamisë. Ka qenë një ndërtesë e vogël, për të cilin do të flasim te shkolla. Në këtë mejtep mësuan shumë fëmijë nga lagja “Perash”. Më vonë është kthyer në shkollë fillore femërore, ku dha mësim Hasan Tahsini (Haveriku). Dhanë mësim mjaft figura të njohura, por më i përmendur u bë në kohën kur dha mësim Hasan Efendia dhe Molla Salih, kohë kur mejtepi mori edhe emrin e këtij të fundit.¹⁸

22. Mejtepi i xhamisë “Begas”

U ndërtua afërsisht rreth gjysmës së dytë të shekullit XVIII nga Bega Behri, përbri xhamisë. Rezistoi deri në vitin 1920, kohë në të cilën u amortizua dhe u bë i papërshtatshëm. Riparimi u bë nevojë emergjente dhe, për këtë arsye, mësuesi i tij, Molla Salih, kërkoi fonde nga IASH për t’i bërë disa riparime. Veçanërisht kishte nevojë për shtrimin me dërrasa të dyshemesë, mbasi ato i ishin kalbur. Edhe pse përgjigjja rezultoi negative, riparimi u bë në këtë vit, po si e qysh nuk është fort e qartë. E qartë është se po në këtë vit mejtepi u kthye në shkollë fillore (azil) për fëmijët. Në

17 Për përshkrimin e këtij mejtepi, autori është mbështetur në këto burime: H. Bushati, vep. e cit., vëll. II, f. 32 dhe Musa Kraja: *Mësuesit për kombin shqiptar*, f. 139. *Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës (1662 – 1945)*, v. 1, f. 45.

18 Për përshkrimin e këtij mejtepi, autori është mbështetur në këto burime: S. Bala, vep. e cit., 2005, f. 198; H. Bushati, vep. e cit., vëll. II, f. 32.

këtë mejtep rezulton të kenë dhënë mësim: Molla Ahmet Kalaja, Molla Salihi, Molla Begu, Hafëz Ibrahim Dibra, Hafëz Halil Hajdari, Hafëz Nuhi, Shaqir Begu i Molla Begut etj.¹⁹

23. Mejtepi i lagjes “Rus i Vogël”

Ky mejtep është ndërtuar në vitin 1880, nga Ali Kraja, me fondet e tij, 20 deri në 30 m larg xhamisë, i cili e ndërtoi për mësimet fetare për fëmijët e lagjes dhe e la vakëf. Ka qenë ndërtesë dykatëshe, me nga dy dhoma poshtë e lart, të ndara me perde dërrase. Ky mejtep u vlerësua shumë dhe u bë i njohur veçanërisht kur aty dha mësim Hafëz Muhamet Kastrati, sidomos për sa i përket përgatitjes së nxënësve për mësimet dhe disiplinës. Ky Hafëz, për një periudhë, mblodhi në këtë mejtep fëmijë të lagjeve të tjera të qytetit të Shkodrës, ata që kishin shkëlqyer në mejtepet e lagjeve të tyre. Krahas mësimet fetare, ai e përgatiti këtë grup për veprimtari fetare, siç ishin dhe janë mevludet. Grupi ftohej vazhdimisht nëpër xhamitë e qytetit dhe të fshatit. Pas një farë kohe, mejtepi u kthye në shkollë. Më vonë, godina e tij u prish dhe aty u ndërtua shkolla e njohur me emrin “Hadrej”. Në mejtep kanë dhënë mësim: Molla Ahmet Kalaja, Mehmet Efendia, Hafëz Jusuf Kraja, Hafëz Ibrahim Kraja, Hafëz Jusuf Karakaçi, Molla Veli Bala, Molla Idrizi, Hafëz Ymer Bakalli, Hafëz Muhamet Kastrati, Hafëz Abdulla Dagistani, Hafëz Molla Bushati, Hafëz Sulejman Myrtja, Hafëz Halil Kali, Hafëz Sulejman Durrësi dhe Hafëz Sabri Koçi.²⁰

24. Mejtepi i lagjes “Rus Maxharr”

U ndërtua me kontributin e familjeve Maxharri dhe Kalaj, por ishte nën kujdesin e familjes Kalaj. Nga sa pamë më sipër, të gjitha këto mejtepe kanë qenë të grumbulluara pranë njëra-tjetrës dhe në rrugën e lagjes “Qafë”, mbase kjo e diktuar edhe nga qetësia e kësaj zone që krijonte kushte për një mësimdhënie normale, larg zhurmave të rrugëve të tjera. Mejtepi ishte nën kujdesin e Muhamet Kalajt. Ndërtesa ka qenë dykatëshe, me nga dy dhoma poshtë e lart, të ndara me perde dërrase në mes. Mejtepi është mbajtur në gjendje të mirë dhe shpesh i janë bërë riparime. Mësimet këtu gjithnjë u zhvilluan normalisht.

19 S. Bala, vep. e cit., 2005, f. 278; AQSHSH, F. 488 i KMSH-së, dosja 23, pa vit.

20 Për përshkrimin e këtij mejtepi, autori është mbështetur në këto burime e dokumente: S. Bala, vep. e cit., 2005, f. 282-83; H. Bushati, vep. e cit., vëll. II, f. 32; AQSH, idem, viti 1926, dosja 20, nr. 91, fleta 115. *Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës (1662 – 1945)*, v. 1, f. 47.

U bë i njohur në kohën që dha mësim Hafëz Muhamet Kali, i cili edhe në kohën kur mejtepi u kthye në shkollë, u emërua këtu mësues besimi, madje një kalim të tillë, nga mejtepi në shkollë, ai e përkrahu pa ndonjë koncept frenues. Karakteristikë, për sa kohë ishte mejtep, ishin veprimtaritë sportive me fëmijët që organizoheshin këtu, sidomos ndeshjet e futbollit ndërmjet lagjeve të qytetit. Në këtë mejtep figuron se kanë dhënë mësim: Hafëz Halil Puka, Hafëz Halil Kalaj, Hafëz Muhamet Kalaj, Hafëz Sulejman Myrtja, Hafëz Ibrahim Dibra, Hafëz Ismail Durrësi.²¹

25. Mejtepi i lagjes “Ndocej”

U ndërtua pak para vitit 1833 nga bamirësja Gjylsime Kaja Hanëmi, e ëma e vezirit Mustafa Pasha. Në vakëfnamen e Mustafa Pashës të këtij viti, në nr. II, shkruhet: *“Hoxhës së mejtepit të lagjes “Ndocej”, i ndërtuar dhe i lënë vakëf nga nëna ime, t’i paguhet rroga e detyrës”*. Në këtë mejtep kanë dhënë mësim: Idriz Boksi (1835, 1840-1860), Molla Abdyl Kadri (Boksi), Hafëz Eljaz Boksi, Hafëz Qerim Kadri (Boksi), Hafëz Idriz Kadri (Boksi), Molla Ahmet Kalaja, Hafëz Xhemal Çanga, Hafëz Sulejman Durrësi, Hafëz Halit Kali, Hafëz Beluli, Hafëz Sabri Efendia, Hafëz Rexhep Boriçi, Hafëz Halim Hajdari, Hafëz Qamil Tresi, Hafëz Hajdar Durrësi.²²

26. Mejtepi i lagjes “Dudas”

Ndërtimi i tij është i hershëm, afërsisht në gjysmën e dytë të shekullit XVIII dhe është bërë me kontributin e banorëve të lagjes. Për një periudhë kohe ai qe nën kujdesin e imamit të xhamisë, Hafëz Ibrahim Repishti, i cili e mbajti gjithnjë në gjendje të mirë. Mbas mbylljes mejtepi, u kthye në shkollë e më pas në kopsht fëmijësh, ku vazhdon të jetë edhe sot, duke u kthyer në pronësi të myftinisë së Shkodrës.

Në mejtep kanë dhënë mësim: Hafëz Ali Jakupi, Ibrahim Efendia, Molla Veli Bala, Hafëz Jonuz Jahja, Hafëz Halil Kali, Hafëz Ali Anamali, Hafëz Ibrahim, Hafëz Jonuz Zahja, Hafëz Ali Ulqinaku, Hafëz Ibrahim Repishti.²³

21 Për përshkrimin e këtij mejtepi, autori është mbështetur në këto burime e dokumente: S. Bala, vep. e cit., 2005, f. 301; H. Bushati, vep. e cit., vëll. II, f. 32; AQSHSH, F. 488 i KMSH-së, viti 1926, dosja 20, nr. 251, fleta 135.

22 Për përshkrimin e këtij mejtepi, autori është mbështetur në këto burime e dokumente: S. Bala, vep. e cit. 2005, f. 319; H. Bushati, vep. e cit., vëll. II, f. 32; AQSHSH, F. 488 i KMSH-së, dosja 23, pa vit, nr. 1783, 1856, nr. proc. 629, 442; Viti 1926, dosja 20, nr. 109, f. 120.

23 Për përshkrimin e këtij mejtepi, autori është mbështetur në këto burime e dokumente: S. Bala,

27. Mejtepi i lagjes “Kiras”

Data e ndërtimit nuk dihet. Ndërtesa qëndron pranë xhamisë, e vogël, njëkatëshe, me dy-tri këmbë shkalla, 3m me 5m me 4.50m. Është bërë i njohur sidomos në kohën që dha mësim Hafëz Ramadan Grizha. Më vonë është shfrytëzuar për kullë sane. Në këtë mejtep kanë dhënë mësim: M. Ahmeti, Hafëz Murat Pirani, Hafëz Lutfi Pirani, Met Osja.²⁴

28. Mejtepi i lagjes “Dërgut”

Ndërtimi i tij është i hershëm, njëherazi me xhaminë, në vitin 1772. Ka qenë një dhomë 5 me 5 me 2.5 m. Qëndroi deri vonë, por nga amortizimi i tepërt dhe mosmirëmbajtja, u prish. Në këtë mejtep kanë dhënë mësim: Mahmud Tivari, Hafëz Ymer Temali, Hafëz Hajdar Durrësi, Hafëz Nezir Kraja, Hafëz Halit Kali, Hafëz Islam Dabi, Hafëz Emin Dibra.²⁵

vep. e cit., 2005, f. 327; AQSHSH, F. 488 i KMSH-së, dosja 23, pa vit.

24 Për përshkrimin e këtij mejtepi, autori është mbështetur në këto burime e dokumente: S. Bala, vep.e cit., 2005, f. 340; H. Bushati, vep. e cit., vëll. II, f. 32; AQSHSH, F. 488 i KMSH-së, viti 1926, dosja 20, nr. 246, fleta 134.

25 Për përshkrimin e këtij mejtepi, autori është mbështetur në këto burime e dokumente: S. Bala, vep. e cit., 2005, f. 176; AQSHSH, F. 488 i KMSH-së, viti 1926, dosja 20, nr. 265, fleta 136.